



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Informata shtesë lidhur me thirrjen për propozimet e datës 12 dhjetor 2012 të publikuara në gazetën Koha ditore.

Bazuar në mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe planin e punës së Zyrës për Informim të MAPL-së, ju lutem të shqyrtoni mundësinë për të realizuar një fushatë informuese që do të përfshijë dy komponentë të rëndësishme të komunikimit:

Objektivi kryesor i kësaj fushate do të jetë opinioni publik ku publikun rreth qytetarët e Kosovës do të informohen, lidhur me të drejtën e tyre në vendimmarrje dhe obligimet e komunave për të komunikuar me qytetarët. I fokusuar në dy komponentë:

Informimi i qytetarëve për procesin e vendimmarrjes në Komuna
Informimi i qytetarëve për mundësinë e përcjelljes on-line të asamblesë komunale

Nevoja për realizimin e kësaj fushate, vjen si domosdoshmëri e inkuadrimin të qytetarit në vendim-marrje dhe krijimit të përgjegjësisë të liderëve komunal për komunikuar me qytetarët.

Nëpërmjet kësaj fushate, MAPL, synon ta avancojë transparencën e pushtetit lokal ndaj qytetarëve dhe të tregoj për përgjegjësitë e Komunave në raport realizimin e transparencës dhe llogaridhënies për qytetarët.

Informatë shtesë

Më 13 prill 2010, MAPL ka lansuar projektin “Platforma për integrimin e zyrave për shërbim të qytetarëve me portalin Ministrisë dhe atë qeveritar për avancimin e shërbimeve komunale CMS/CSC”.

Rëndësia e këtij projekt konsiston në involvimin e qytetarit në vendim-marrje si dhe sigurimin e transparencës, me transformimin e shërbimeve komunale nga forma klasike në atë elektronike. Projekti mundëson shndërrimin e web faqeve komunale nga gazeta elektronike në platforme të fuqishme ndërveprimi si dhe gjenerimin e treguesve të suksesit në formën On-line, On-time lidhur me performancën e Asamblesë Komunale si dhe Administratës Komunale në raport me detyrimet ligjore dhe Qytetarin.

Platforma për integrimin e zyrave për shërbim të qytetarëve me portalin Ministrisë dhe atë qeveritar për avancimin e shërbimeve komunale CMS/CSC”, ka avancuar edhe me mundësinë e Përcjelljes on-line e mbledhjeve të asamblesë komunale nga MAPL si dhe momentalisht of line për qytetarët që pritet të mundësohen edhe përcjellja on line nga qytetarët deri në muajin mars 2013.

Subjekt i kësaj fushate janë qytetarët të cilët do të informohen për mundësitë e komunikimit elektronik me komunat.

Specifikimi teknik

Fushata informuese është planifikuar të përfshijë informimin e qytetarëve nëpërmjet mediave duke siguruar TV DHE Radio Spote, Dokumentarë, billborde, lifleta në gjuhët zyrtare në Kosovë, që do të transmetohen në gjithë territorin e Kosovës.

Tv dhe radio spote

Rrafshi medial duhet të ketë synim praninë në mediat publike dhe private me shtrirje kombëtare në veçanti në mediat lokale. Radio dhe shtypi duhet të përdoren si pjesë e rëndësishme plotësuese e pjesës mediale të fushatës. TV dhe Radio spotet janë të rëndësishme për zgjerimin e informatave për qytetarët si dhe zhvillimit të transparencës në komuna.

Fushata e planifikuar të fillojë në muajin mars dhe të përfshijë

- spote televizive
- radio spote
- dokumentarë televizive
- emisione televizive
- Lifleta Informuese, billborde
- Tryeza me grupe të interesit(shoqëria civile, komuniteti medial)

Koha e përshtatshme për fillimin e fushatës do të ishte mesi i majit mars 2013.

Në të gjitha fazat e implementimit Zyra për Informim do të përgatis, menaxhojë dhe monitorojë gjithë fushatën.
